

VENDIM
Nr. 33, datë 26.3.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA
NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9, nenit 13 pika 1 germa “ç” dhe nenit 45 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pikat 1 germa “a” dhe 3, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.3.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albpetrol” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol” sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar pjesërisht (mungon ekstrakti i QKR-së).
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht. (Mungon neni 9, pika 3 germa “a” (vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj institucioneve të sigurimeve shoqërore)).
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. Ndërsa për pikën “c” të këtij neni, subjekti nuk ka dhënë asnjë informacion.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani